

Danja Hobdari

Mban pozicionin e Drejtorit të Njesisë së Shërbimeve të Përgjithshme Ligjore, pranë Departamentit të Shërbimeve Ligjore, në Këshillin e Lartë të Prokurorisë. Është diplomuar në “Drejtësi”, në Universitetin “Lumière”, Lyon II në vitin 2010. Në vitin 2012, ka përfunduar programin e studimeve Master i Shkencave, pranë Fakultetit Juridik, të Universitetit European të Tiranës, në profilin “E drejtë private”. Në vitin 2016, ka mbrojtur gradën shkencore Doktor, në profilin “Histori”, me specialitet “Histori e së drejtës”, pranë Akademisë së Studimeve Albanologjike.

Ka një eksperiencë rreth 8-vjeçare në administratën publike dhe në sektorin privat. Nga viti 2014, ka ushtruar funksionin e juristes në Drejtorinë e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar, në varësi të Kryeministrit, dhe në Ministrinë e Integritit European.

Më tej, nga fundi i vitit 2016 deri në vitin 2019, ka punuar pranë Kolegjit Profesional të Biznesit, si shefe e departamentit të së drejtës private dhe tregtare, dhe ka qenë profesor i disa moduleve të së drejtës private, në ciklin e parë dhe të dytë të studimeve pranë këtij kolegji.

Prej vitit 2013 e në vijim, ka marrë pjesë në konferenca shkencore kombëtare dhe ndërkombëtare, si dhe ka publikuar artikuj shkencorë në revista brenda dhe jashtë vendit. Gjatë kësaj periudhe ka qenë pjesë e grupeve të punës për hartimin e disa projektakteve, si dhe aktive në procesin e integritit european, në përafrimin e legjislacionit dhe në hartimin e kontributeve të Shqipërisë për Bashkimin European, në kuadër të procesit të anëtarësimit. Ka marrë pjesë gjithashtu në mënyrë sistematike në trajnimet e organizuara nga Shkolla Shqiptare e Administratës Publike (ASPA) dhe institucione të tjera.

Zotëron njohuri shumë të mira të gjuhës franceze, angleze dhe italiane.